



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 68, datë 26.05.2017

PËR

**MARRJEN E MASAVE NDAJ AGJENTIT TË BROKERIT TË LICENCUAR TË
LETRAVE ME VLERË SHOQËRISË “STOCK INTERNATIONAL ALBANIA” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14 dhe 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 57, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, si dhe të Vendimit të Bordit të AMF-së nr. 55, datë 30.03.2011 “Për njohjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë”, i ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Në zbatim të Urdhrit nr. 77, dt. 03.05.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, në mbështetje të nenit 19, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, në datat 10 dhe 11 maj 2017, është zhvilluar inspektim në vend, pranë shoqërisë “Stock International Albania” sh.a.

Shoqëria “Stock International Albania” sh.a. me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 56, datë 30.06.2015, ka marrë miratimin për të ushtruar veprimtarinë e agjentit të brokerit në letra me vlerë në emër dhe për llogari të shoqërisë “LeadCapital Markets” Ltd.

Nga monitorimi dhe inspektimi i kryer ka rezultuar se shoqëria “Stock International Albania” sh.a:

- Duke filluar nga mesi i muajit mars 2017 ka mbyllur zyrën nga e cila zhvillonte aktivitetin dhe ka larguar stafin, si pasojë e vështirësive financiare të shoqërisë. Aksionari i shoqërisë ACECAP Investment Ltd, (regjistruar në Qipro) nuk financon më shpenzimet e “Stock International Albania” sh.a.
- Nuk disponon asnjë mjet teknik për të siguruar lidhjet mes klientëve dhe shoqërisë “LeadCapital Markets”.
- Nuk ka raportuar mbi pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe mbi aktivitetin e kryer për periudhën 1 janar-31 mars 2017.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në nenin 57, paragrafi i parafundit të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt” t’i kërkojë shoqërisë “Stock International Albania” sh.a, që brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e këtij vendimi të depozitohet në Autoritet:
 - i) Informacionin në lidhje me njoftimin e të gjithë klientëve të vet mbi ndërprerjen e aktivitetit;
 - ii) Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë dhe vendimin e Këshillit Mbikëqyrës për situatën e shoqërisë.
2. Përmbajtja e njoftimit për klientët duhet të depozitohet në AMF brenda datës 06.06.2017.
3. Bazuar në nenin 147, të Ligjit nr. 9879, dt. 21.02.2008 “Për titujt”, si dhe pikës 9, të Vendimit nr. 55, dt. 30.03.2011, shoqëria “Stock International Albania” sh.a., për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në këtë ligj, sanksionohet me gjobë në masën 100,000 (njëqind mijë) lekë.
4. Pas afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, Autoriteti do të shqyrtojë dhe do të vendosë masat e parashikuara në nenin 57, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”.
5. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI